



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 tetor 2016
Nr. ref.: RK989/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI146/15

Parashtrues

Azem Brajshori

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që
lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0311-A0001-
A0023, të 15 korrikut 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Azem Brajshori nga komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit) [AC-I-14-0311-A0001-A 0023], të 15 korrikut 2015, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 7 tetor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar. Parashtruesi i kërkesës nuk ka saktësuar se cila dispozitë kushtetuese mund të jetë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 dhjetor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 22 janar 2016, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.
7. Më 22 shkurt 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Kolegjin e Apelit për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 11 korrik 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues, në vend të gjyqtarit Robert Carolan.
9. Më 12 korrik 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi njëzëri Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës ishte punëtor i Ndërmarrjes tregtare shoqërore “Urata-Voqar” (në tekstin e mëtejme: “Urata-Voqar”) deri më 1 janar 1996.
11. Më 2 maj 2007, “Urata-Voqar” ishte privatizuar.
12. Në një datë të paspecifikuar, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) e publikoi listën e përkohshme të punëtorëve të cilët kanë të drejtë në 20% të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes. Parashtruesi i

kërkesës nuk ishte i përfshirë në atë listë. Gjithashtu, AKP-ja ka përcaktuar afatin ligjor deri më 3 tetor 2009, ku palët e pakënaqura kishin të drejtë ankese kundër listës së përkohshme.

13. Më 21 korrik 2011, AKP-ja ka publikuar listën përfundimtare të punëtorëve të cilët kishin të drejtë për një pjesë të të ardhurave të krijuara nga privatizimi i “Urata-Voqar”, në të cilën parashtruesi nuk ishte i përfshirë.
14. Më 30 shtator 2011, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: Kolegji i Specializuar) pas skadimit të afatit ligjor, duke pretenduar se ka të drejtë në 20% të të ardhurave nga privatizimi, sepse ka 11 (njëmbëdhjetë) vite, 7 (shtatë) muaj dhe 3 (tri) ditë përvojë pune në këtë ndërmarrje.
15. Më 14 nëntor 2011, AKP-ja ka dërguar përgjigjen e saj ndaj ankesës së parashtruesit në Kolegjin e Specializuar, duke theksuar se “*ankesa në Listën përfundimtare është bërë pas kohës së caktuar me ligj*”. AKP-ja ka propozuar që ankesa të refuzohet si e papranueshme.
16. Më 29 shtator 2014, Kolegji i Specializuar, nxori Aktgjykimin [SCEL-11-0045], me të cilin e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të paafatshme.
17. Më tutje, në Aktgjykim, arsyetohet se “[...] Gjykata duke shikuar shkresat e lëndës, ka vërtetuar se ankuesja ankesën e ka dorëzuar në DHP më 30.09.2011, Lista përfundimtare është shpallur më 21.07.2011, kurse afati i fundit për ushtrimin e ankesës në DHP ka qenë më 13.08.2011, që do të thotë se është ushtruar pas afatit ligjor [...]”.
18. Më 24 tetor 2014, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar ankesë në Kolegjin e Apelit ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar SCEL-11-0045, të 29 shtatorit 2014.
19. Më 15 korrik 2015, Kolegji i Apelit, me Aktgjykimin [AC-I-14-0311-A0001-A0023], e refuzoi ankesën dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar. Më tutje, në aktgjykim theksohet:

“[...] Në fazën e ankesës, ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi me të cilën do e arsyetonte lëshimin e afatit për parashtrimin e ankesës, për këtë arsye Kolegji i Apelit ankesën e refuzon si të pabazuar dhe e vërteton aktgjykimin e kundërshtuar lidhur me këtë ankues”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi në kërkesë ka potencuar se i është bërë padrejtësi sepse nuk është futur në listën e përfituesve të 20 % nga shitja e ndërmarrjes “Urata-Voqar”, pasi që sipas tij, ai i ka plotësuar kushtet për të qenë në këtë listë.
21. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën që: “*të më njihet e drejta ime që kam punuar në këtë ndërmarrje prej 28.05.1984 e deri me 01.01.1996 [...] disa*

punëtor të cilët kanë të njëjtin status sikur unë, janë të kyqur në regjistrin përfundimtar 20%”.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

25. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

26. Gjykata, vëren se parashtruesi në kërkesën tij nuk kishte saktësuar se cilat të drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutë janë shkelur me vendimin e Kolegjit të Apelit apo me vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta, siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit.

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon *“më janë shkelur të drejtat e mija se kam punuar në këtë ndërmarrje 12 vjet”*. Parashtruesi ka deklaruar se nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë në krahasim me punëtorët e tjerë të *“Urata-Voqar”*.

28. Ky pretendim është i pabazuar sepse ai nuk ka treguar bazën e kësaj pabarazie.
29. Gjkata vlerëson se në procedurën e mbajtur nuk ka fakte apo rrethana që në çfarëdo mënyre do të tregonin se në procedurat në Kolegjin e Apelit, parashtruesit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë.
30. Gjkata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij dhe as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (Shih rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syl*a, Gjkata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA nr. 1947/2013 të 5 dhjetorit 2013).
31. Gjkata konsideron se kriteret, sipas të cilave ankesa e parashtruesit do të shqyrtohej nga aspekti i shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, nuk janë përmbushur.
32. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjkata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 12 korrik 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Ivan Čukalović



Arta Rama-Hajrizi

